



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:269547  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05527805

PAKR.nr.78/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku- kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. M për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević dhe ankesës së mbrojtësit tjetër të akuzuarit M. M, av. Dejan Vasić, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2022 i datës 15.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, mbrojtësit të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević dhe mbrojtësit tjetër të akuzuarit M. M av. Dejan Vasić, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.3/2022 i datës 15.01.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.3/2022 të datës 15.01.2024, të akuzuarin M. M për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën njëzet euro (20 €), si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasoja e përmbarimit të dhunshëm.

Në mbështetje të nenit 272 par.2 të KPRK-së dhe nenit 276 par.1 dhe par.2 nënpar. 2.4 të KPPRK-së nxori urdhrin me të cilin urdhërohet konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike që lidhet me këtë rast në peshë të përgjithshme prej 792.22-0.00001 gram, e cila substancë narkotike do të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënim aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të Krime të Rënda PKR.nr.3/2022 i dt. 15.01.2024, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me burg efektiv me kohëzgjatje më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të Krime të Rënda PKR.nr.3/2022 i dt. 15.01.2024, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim të kushtëzuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj burg, në kohën të cilën e cakton Gjykata e Apelit në Prishtinë.

Mbrojtësi tjetër i të akuzuarit M. M, av. Dejan Vasić, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të Krime të Rënda

PKR.nr.3/2022 i dt. 15.01.2024, ashtu që të akuzuarit të ia zëvendësoj dënimin me burgim në dënim me gjobë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.92/2024 e datës 13.02.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.3/2022 (2021:269547) i dt. 15.01.2024 dhe i njëjti aktgjyqim të ndryshohet ashtu që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i lartë me burg. Ndërsa, të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević dhe av. Dejan Vasić.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra nga palët ndonëse të njoftuara me kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-se dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M. M av. Milivoje Dordević dhe mbrojtësit tjetër të akuzuarit Milijan Milivojević, av. Dejan Vasić, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë pretendon se Gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar të akuzuarit një dënim të butë dhe jo adekuat për veprën e kryer penale. Kjo sepse sipas Prokurorit Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit nën minimumin e paraparë për këtë veprë penale, nuk ka marrur parasysh rrethanat rënduese siç është pesha e rëndë e veprës penale për të cilën është shpallur fajtori i akuzuari, pasi që me të njëjtën nxitet një numër i madh i të rinjve apo qytetarëve të tjerë, që do të ndikonte në shëndetin e qytetarëve dhe rritjen e numrit të qytetarëve që kryejnë vepra të tilla.

Po ashtu, Prokurori konsideron se pranimi i fajësisë si nuk do të duhej të merrej për bazë fare si rrethane lehtësuese, sepse në rastin konkret ka pasur prova të mjaftueshme të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si konfiskimi i narkotikëve dhe ekspertiza e forenzikës.

Sipas Prokurorit me një dënim kaq të butë Gjykata do të ndikoj keq në opinion sepse qytetarët do të mund të përfshihen në kryerjen e këtyre veprave penale, e sidomos të rinjtë duke blerë narkotik nga i akuzuari, që do të rezultonte në rrezikimin e shëndetit të qytetarëve. Prokurori pretendon se me një dënim kaq të butë nuk do të arrihet risocializimi i të akuzuarit në shoqëri.

Prokurori shton se Gjykata nuk ka marrur parasysh faktin se në kohët e fundit veprat penale të narkotikëve janë në rritje e sipër, mbështetur në media dhe televizione, e rritja e të njëjtave shkakton frikë dhe ankth tek qytetarë për fëmijët e tyre të cilët mund të përfshiheshin në këto vepra penale.

#### Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević

Mbrojtësi thekson se Gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar këtë rast në mënyrë objektive, mirëpo konsideron se qëllimi i dënimit do të arrihej edhe me shqiptimin e dënimit me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj për periudhën kohore të cilën e cakton Gjykata e Apelit në Prishtinë, në mbështetje të nenit 499 par.2 të KPRK-së.

Po ashtu, mbrojtja lut Gjykatën e Apelit që të miratoj ankesën e tij dhe të mos ia komplikoj jetën më tepër të akuzuarit për shkak se i njëjti së voni është punësuar në minierën Belo brdo, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe është i moshës së re.

Së fundmi, mbrojtja thekson se i akuzuari veprën penale për të cilën ngarkohet e ka kryer pa vetëdije, nga kureshtja dhe asnjëherë më herët nuk është marrur me veprimtari të tilla, nga e njëjtat nuk ka pasur ndonjë dobi dhe nuk i ka shitur askujt substanca narkotike.

#### Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit M. M, av. Dejan Vasić

Mbrojtësi përmes ankesës, me pëlqimin e të akuzuarit, kërkon zëvendësimin e dënimit me burgim gjashtë (6) muaj në dënim me gjobë ose në kryerjen e ndonjë pune në interes publik. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që pas përcaktimi të besueshmërisë së bazave të ankesës, të caktoj shumën e gjobës në përputhje me nenin 44 par.2 të KPPRK-së.

#### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Ndonëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se i njëjti nuk përmban

shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë i akuzuar ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe mbrojtësve të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević dhe av. Dejan Vasić sa i përket vendimit mbi dënimin.

### Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë mbrojtësve të akuzuarit M. M, av. Milivoje Dordević dhe av. Dejan Vasić, janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1 pika 1.3 e lidhur me nenin 72 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, sipas të cilës dispozitë ligjore parashihet se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit, duke vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari, shprehjen e keqardhjes, pendimin e të akuzuarit për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale, faktin që është hera e parë që bie ndesh me ligji dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme. Ndërsa rrethana rënduese Gjykata e shkallës së parë nuk gjeti.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimin i Prokurorit se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar rrethanën rënduese të peshës së veprës penale dhe nuk është dashur të e vlerësoj pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese, është pretendimi i pa bazuar pasi në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe mos gjetjes së rrethanave rënduese, dhe si rezultat i tyre të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin përkatës nën minimumin e dënimit paraparë me KPRK-së. Po ashtu, propozimet e mbrojtësve të akuzuarit, ky Kolegj i

vlerësoi si të pa bazuara sepse dënimi i shqiptuar është adekuat për veprën penale dhe rrethanat në të cilat është kryer. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.78/24, datë 27.03.2024

Praktikantja gjyqësore  
Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit  
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit  
Hashim Çollaku

\_\_\_\_\_

Xhevdet Abazi

\_\_\_\_\_